

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“IDEAL PUBLICITY” SH.P.K.

Sot, më datë ___.05.2023 (*dymjë e njëzet e tre*), në Tiranë, në selinë me adresë: *Tiranë, Rruga “Qemal Stafa”, P. 16, H. 4, K.1, Ap.32, me Nr. pasurie 1194, Zona Kadastrale 8170*, janë të pranishëm antarët themelues si më poshtë vijon:

- **Shoqëria "RE - ALIS Albania" sh.p.k,** me Nuis **M22204030T**, dhe adresë **TIRANË** Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Emin Duraku", godina me nr. pasurie 1/102, zona kadastrale 8270.

Me përfaqësues:

-**Aurel Zyka**, lindur në Berat, më 08.05.1985, banues në Berat, me letërnjoftim ID, me Nr. personal **I50508278V**.

-**Asllan Ruko**, lindur në Fier, më 02.05.1992, banues në Fier, me letërnjoftim ID, me Nr. personal **J20502025V**.

-**Simon Jeger, (Simon Jäger)**, lindur në Gjermani, më 19.09.1989, banues në Gjermani, me letërnjoftim, me Nr personal **L325K9FYH**.

-**Ardit Hoxha**, lindur Berat, më 16.06.1995, banues në Berat, me letërnjoftim ID, me Nr personal **J50616004G**.

Së bashku, me vuilnetin e tyre të lire dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet këtij Akt Themelimi, ranë dakord për krijimin e **Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar “IDEAL PUBLICITY” SH.P.K.** (më poshtë referuar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statutit duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.


NENI 1 **EMËRTIMI**

1.1. Emri tregtar i shoqërisë është **“IDEAL PUBLICITY” sh.p.k.**

2.2. Forma ligjore e shoqërisë është **“Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” (sh.p.k).**

NENI 2 **SELIA**

2.1. Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në adresën: *Tiranë, Rruga “Qemal Stafa”, P. 16, H. 4, K.1, Ap.32, me Nr. pasurie 1194, Zona Kadastrale 8170.*



NENI 3
KOHËZGJATJA

- 3.1.** Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare "IDEAL PUBLICITY" sh.p.k. është e pakufizuar.
- 3.2.** Personaliteti juridik i shoqërisë mbaron ditën e ç'regjistrimit të saj si shoqëri pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- 4.1. "IDEAL PUBLICITY" sh.p.k.** është një shoqëri, objekti i së cilës janë aktivitetet e mëposhtme:

- Operimi në fushën e marketingut dhe marrëdhënieve me publikun. Përgatitja e reklamave, zhvillimi i strategjisë përfitorimin efektiv të masmedias. Përgatitja dhe printimi i posterave të ndryshëm, prodhimi dhe tregtimi i programeve, videove, filmave të gjitha llojeve.
- Organizimi i kongreseve ekspozitive, koncerteve dhe forumeve të gjitha llojeve.
- Shërbim konsulencë promovimi për shoqëri të ndryshme, realizimi i spoteve të ndryshëm publicitare etj. Krijimi dhe menaxhimi i faqeve të internetit etj.

- 4.2.** Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e asamblesë së ortakëve.

NENI 5
KAPITALI THEMELTAR

- 5.1. Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 (*njëqind mijë*) Lekë.**
- 5.2.** Kapitali themeltar është i përbërë nga 2 (*dy*) pjesë kapitali me vlerë 75.000 (*shtatëdhjetë e pesë mijë*) Lekë dhe 25.000 (*njëzet e pesë mijë*) Lekë, të shlyera në masë 100% (*njëqind përqind*) nga ortakët themelues. Ai mund të zmadhohet dhe të zvogelohet me vendim të ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.

NENI 6
KONTRIBUTET DHE PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

- 6.1.** Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000.00 (*njëqind mijë*) Lekë. Kapitali i mësipërm është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga ortakët themelues të shoqërisë dhe është i ndarë në 2 (*dy*) kuota.

Pjesëmarra e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. "RE - ALIS Albania" sh.p.k. me Nuis M22204030T, dhe adresë: *Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga "Emin Duraku", Godina me nr. pasurie 1/102, Zona Kadastrale 8270*. Me kuotë me vlerë **25.000 (*njëzet e pesë mijë*) Lekë**, e cila përbën **25% (*njëzet e pesë përqind*)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me përfaqësues dhe pjesë si më poshtë:

- a. Aurel Zyka, lindur në Berat, më 08.05.1985, banues në Berat, me leternjostim ID, me nr. personal **I50508278V**.

Vlera e kapitalit të per gjithshëm **8.500 (tetëmijë e pesëqind) Lekë**, numri i pjesëve **1 (një)**, që përbën **8.5% (tetë pikë pesë përqind)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- b. Asllan Ruko, lindur në Fier, më 02.05.1992, banues në Fier, me leternjostim ID, me nr. personal **J20502025V**.

Vlera e kapitalit të përgjithshëm **8.500 (tetëmijë e pesëqind) Lekë**, numri i pjesëve **1 (një)**, që përbën **8.5% (tetë pikë pesë përqind)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- c. Simon Jeger (Simon Jäger), lindur në Gjermani më 19.09.1989, banues në Gjermani, me leternjostim me nr. personal **L325K9FYH**.

Vlera e kapitalit të **8.500 (tetëmijë e pesëqind) Lekë**, numri i pjesëve **1 (një)**, që përbën **8.5% (tetë pikë pesë përqind)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2. Ardit Hoxha lindur Berat, më 16.06.1995, banues në Berat, me leternjostim ID, me nr. personal **J50616004G**.

Vlera e kapitalit të përgjithshëm **75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) Lekë**, numri i pjesëve **1 (një)**, që përbën **75% (shtatëdhjetë e pesë përqind)** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

6.2. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqesohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

6.3. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve, deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 7

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

7.1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe nga Statuti i Shoqërisë.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

8.1. Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- a) **Asambleja e Përgjithshme**
b) **Administratorët**

NENI 9 ASAMBLEJA



9.1. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, e cila përbëhet nga të gjithë ortakët e saj, është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti depozitohet pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

9.2. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve në fushën e finansës;
- e) përcaktimin e shpërblimeve;
- f) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregetare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përsaqsimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj;
- m) ndarjen e dividenteve;
- n) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

9.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortakët e saj duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilët, nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

9.4. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ky ligj, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën 1(një) herë në vit.

NENI 10 **ADMINISTRIMI**

10.1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administratorë, të cilët mund të zgjidhen nga rradhët e ortakëve të shoqërisë ose persona të jashtëm të saj.

10.2. Administratorët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Emërimi i administratorëve prodhon efekte, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

10.3. Mandati i Administratorit është i vlefshëm për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje.

10.4. Mandati fillestar ushtrohet nga Administratori **Z. Mehmet Hoxha**, lindur në Berat, më 03.01.1964, banues në Berat, me letërnjoftim nr. personal **G40103001N**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

10.5. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrëthanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.



NENI 11
LIGJI I ZBATUESHM

- 11.1.** Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 11.2.** Përveç sa parashikohet në statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çdo ligj tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 12
MOSMARRËVESHJET

- 12.1.** Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi gjatë funksionimit të shoqërisë, midis ortakëve, midis një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarëve për t'i zgjidhur me pajtim.
- 12.2.** Në rast të kundërt do të jetë në kompetencë ekskluzive të Gjykatës së Rethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13
HYRJA NË FUQI

- 13.1.** Ky Akt Themelimi hyn në fuqi në ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë, në këtë ditë shoqëria tregtare "IDEAL PUBLICITY" sh.p.k. njihet edhe si person juridik.

NENI 14
DISPOZITA TË TJERA

- 14.1.** Ky Akt Themelimi hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (*katër*) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore.

**ORTAKËT THEMELUES
TË SHOQËRISË "IDEAL PUBLICITY" SH.P.K.**

1. Aurel Zyka

2. Asllan Ruko

3. Simon Jager

4. Ardit Hoxha

Tiranë, më 04.05.2023